

Dr. A.S. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent

13 Janar, 2023

Të Nderuar Prindër dhe Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Në Dhjetor, tregova se kishim hyrë në fazën përfundimtare të tranzicionit tim trefazor, zhvillimin e Planit Strategjik 5-vjeçar të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. Zhvillimi i Planit Strategjik do të drejtohet nga disa Grupe Këshilluese, një Komitet Drejtues dhe një Ekip Udhëheqës – tre organe të dallueshme që përfaqësojnë shumëllojshmërinë e gjerë të perspektivave dhe ekspertizën e ndryshme të komunitetit tonë të SDP-së.

Sot, jam i emocionuar të njoftoj anëtarët e ekipit të Planifikimit Strategjik. Ju lutemi, klikoni lidhjet më poshtë për t'u drejtuar në "[Strategic Plan website](#)" dhe të gjeni emrat e anëtarëve të Ekipit tonë Udhëheqës, Komitetit Drejtues dhe Grupet Këshillues.

[Ekipi Drejtues](#) |

[Komitet Drejtues](#) |

[Grupet Këshilluese](#)

Unë gjithashtu dua të ndaj disa data të rëndësishme që përfaqësojnë pika kyçe në procesin e planifikimit strategjik. Unë mbetem i përkushtuar t'ju mbaj të informuar gjatë gjithë procesit të planifikimit, në mënyrë që të prisni përditësime në ose afër këtyre datave.

- **23 Janar 2023:** Nisja e Anketës së Misionit, Vizionit dhe Vlerave Bazë
- **23 Mars 2023:** Propozim mbi Teorinë e Veprimit dhe Prioritetet për të informuar planin përfundimtar
- **27 Prill 2023:** Ndarja e Qëllimeve dhe Strategjive për të informuar planin përfundimtar të duhur
- **26 Maj 2023:** Bordi i Arsimit miraton Planin Strategjik përfundimtar

Përcaktimi i Misionit, Vizionit dhe Vlerave Thelbësore të Drejtorisë është një pikënisje kritike në zhvillimin e Planit Strategjik. Prandaj anketimi, i cili nis më 23 Janar, do të jetë një mundësi për të ndërtuar mbi gjithçka që ndatë me mua gjatë turneut dëgjimor dhe mësimor në vjeshtë, dhe për të ndikuar drejtpërdrejt në drejtimin e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. Ju inkurajoj ta plotësoni anketimin me sinjeritet – kontributi juaj është i rëndësishëm për mua. Dhe shpresoj se do të ndiqni progresin dhe do të jeni në kërkim të mënyrave shtesë për t'u përfshirë, në faqen tonë të internetit të Planit strategjik: www.philasd.org/strategicplan.

Unë jam jashtëzakonisht mirënjohës për çdo punonjës të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, student, pjesëtar të familjes dhe palë të interesuara të komunitetit që janë angazhuar në procesin e tranzicionit deri tani. Unë jam veçanërisht mirënjohës për anëtarët individualë të Ekipit të Planifikimit Strategjik dhe nga dëshira e tyre për t'u shërbyer studentëve dhe familjeve të Filadelfias me përsosmëri. Jam i gëzuar për të punuar së bashku me këto grupe për të krijuar një plan ambicioz dhe gjithëpërfshirës që do të përcaktojë rrugën tonë drejt arritjes së Objektivave dhe Qëllimeve të Bordit të Arsimit dhe për t'u bërë drejtoria arsimore më e madhe urbane që përmirësohet më shpejt në vend. Faleminderit që u bashkuat me ne në udhëtim!

Në partneritet,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent

Drejtoria Arsimore e Filadelfias

Translation and Interpretation Center (1/2023)

Jan 2023 Strategic Plan Update (Albanian)